“PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN:
“MBI EMETIMIN E OBLIGACIONEVE AFATGJATA TË QEVERISË NË FORMË RREGJISTRIMI”

midis
BANKËS SË SHQIPËRISË
përfaqësuar nga Guvernatori

dhe

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
përfaqësuar nga Ministri i Financave

Sot, më 01/12/2010 bazuar në:

a) Ligjin Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
b) Ligjin Nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”
c) Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 678, datë 14.10.1996 “Për përdorimin e letrave me vlerë për mbulimin e deficitit buxhetor”
d) Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 350, datë 18.07.2002 “Për emetimin e obligacioneve afatgjata me maturim më të madh se një vit”;
e) Marrëveshjen e datës 28.09.2007 ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për “Emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve afatgjata të qeverisë në formë regjistrimi”, e ndryshuar.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Në Nenin 2, pika 2 të ndryshojë sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Ministria në varësi të kushteve të tregut dhe në përputhje me strategjinë e saj për menaxhimin e borxhit publik rezervon të drejtën e rihapjes së ankandeve.

Obligacioni i rihapur mban të njëjtën datë maturimi, të njëjtin kupon, ose të njëtin marzh në rastin e obligacioneve me kupon të ndryshueshëm, me obligacionin egzistues. Ndërsa, data e emetimit dhe çmimi përcaktohen në ankandin e rihapjes. Blerësit do të konkurrojnë në bazë të yield-it, dhe bazuar në yield-in e pranuar, do të përcaktohet edhe çmimi i obligacionit” .

Neni 2

Në Nenin 2, pika 3 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Obligacionet do të emetohen me *“par value”*. Kjo do te thotë që çmimi i blerjes së tyre është i barabartë me 100% të vlerës nominale. Përjashtim nga ky rregull bëjnë obligacionet e emetuara gjatë ankandeve të rihapura, në përputhje me Nenin 2, pika 2.

Në rastin e emetimit të obligacioneve me kupon fiks, në njoftimin e çdo ankandi Ministria do të japë kuponin indikativ, ndërsa kuponi përfundimtar do të jetë i barabartë me yield-in maksimal të pranuar të ankandit, i cili do të zbatohet në mënyrë uniforme për të gjithë pjesëmarrësit fitues.

Llogaritja e kuponat bëhet me bazën 30/360 ditë.”

Neni 3

Në pikën 2 të Nenit 13 shtohet fjalia sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Në rast të paraqitjes së më shumë se 3 (tre) kërkesa nga një subjekt, përjashtohet(n) nga ankandi kërkesa(t) me yield-in më të lartë.”

Neni 4

Në nenin 17, shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Ankandet e jashtëzakonshme të përshkruara në Nenin 4 të marrëveshjes mund të bëjnë përjashtim nga rregulli T+2.”

Neni 5

Pikat 2 dhe 3 të Nenit 17 rinumërohen respektivisht 3 dhe 4.

Neni 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë.

Për Ministrinë e Financave	**Për Bankën e Shqipërisë**
Ridvan BODE **MINISTER**	**Ardian FULLANI** **GUVERNATOR**